



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Nr.478/ 21

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, nenin 4 i “Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimin të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave”, si dhe nenin 17 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së OE “Storm ICT LLC” me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me projektor dhe mbajtës për shkollat e mesëm” me nr. prokurimi “651-21-1943-1-2-1, te iniciuar nga AK Komuna e Gjilanit. Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardian Behra me datën: 18 qershor 2021 mori këtë :

VENDIM

- I. **Hedhet si e pa lejuar** ankesa e OE “Storm ICT LLC” me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me projektor dhe mbajtës për shkollat e mesëm” me nr. prokurimi “651-21-1943-1-2-1, te iniciuar nga AK Komuna e Gjilanit.
- II. **I LEJOHET** autoritetit kontraktues – Komuna e Gjilanit që të vazhdoj më tutje, me

procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me projektor dhe mbajtës për shkollat e mesëm” me nr. prokurimi “651-21-1943-1-2-1, te iniciuar nga AK Komuna e Gjilanit (nëse nuk ka ankesë tjetër).

- III.** Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 17.06.2021, ka pranuar ankesë nga OE “Storm ICT LLC” me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me projektor dhe mbajtës për shkollat e mesëm” me nr. prokurimi “651-21-1943-1-2-1, te iniciuar nga AK Komuna e Gjilanit.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se për aktivitetin e prokurimit në fjalë AK me datën-04.06.2021 në orën 15:01, ka publikuar Letrat Standarde dhe Njoftimi mbi vendimin e AK-së

Kundër vendimit të lartcekur ankues “ Storm ICT LLC” Prishtine ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim tek AK me datën 09.06.2021 në ditën e 5-të kalendarike por në orën 17:37.

AK është përgjigjur në kërkesën për rishqyrtim me datën 10.06.2021 në orën 15:02 ku e ka hedhur poshtë si të pa afateshme kërkesën e OE në fjalë .

OE ka parashtruar ankesën në OSHP e-prokurim me datën 16.06.2021 në orën 17:34 dhe e njëjta është protokolluar me datën 17.06.2021.

Organi shqyrtues i prokurimit sqaron se duke pas parasysh faktin se AK Njoftimin për dhinë të kontratës dhe Letrën standarde e ka publikuar me datën 04.06.2021, afati ligjor për kërkesë për rishqyrtim në AK, për operatorët e ekonomik ka filluar të rrjedh nga data 05.06.2021 duke filluar nga ora 08:00 deri në ora 16:00, dhe ky afat kohor ka përfunduar me datën 09.06.2021 ora 16:00(duke pas përsysh faktin se dita e njoftimit llogaritet dita 0).

OSHP konstaton se nga verifikimet konstatohet se Kërkesa për rishqyrtim nga OE tek AK ka qenë jashtë afatit ligjor nga se është ngarkuar në e-prokurim 1 orë e 37 minuta pas përfundimit të orarit zyrtar të punës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se OE “Storm ICT LLC” Prishtinë me seli në Prishtinë, ka humbur afatin ligjor për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim në AK andaj ankesa e datës 17.06.2021 me numër të protokollit 478/21, nuk mund të shqyrtohet nga OSHP dhe e njëjta hedhet si e pa lejuar .

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se neni 5 i LPP-së specifikon :

Kalkulimi i afateve kohore

1. Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.

Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj

Sepse neni 9 paragrafi 1 i “Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave” specifikon: *Ankesa pranë OSHP-së, duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure*

paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe te dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 109 të LPP-së.

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lart OSHP konstaton se ankesa e parashtruar në OSHP nga OE “Storm ICT LLC” Prishtinë hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi ka parashtruar ankesë në OSHP në kundërshtim me nenin 108/A dhe nenin 109 të LPP-së si dhe nenin 9 të Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimi të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave”, andaj e njëjta nuk hyn në shqyrtim nga OSHP.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t’i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t’i dorëzohet:

1x1 AK Komuna e Gjilanit

1x1 OE “Storm ICT LLC” Prishtine

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së

